



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force
NJOFTIM PËR KONTRATË PUBLIKE KORNIZE

SHERBIME&FURNIZIME

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 04.03.2016

Nr i Prokurimit	21700	16	004	211&111
------------------------	--------------	-----------	------------	--------------------

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës		
Adresa Postare: Kazerma “ Adem JASHARI”		
Qyteti: PRISHTINË	Qyteti: PRISHTINË	Qyteti: PRISHTINË
Personi kontaktues: Afrim Maxhuni	Personi kontaktues: Afrim Maxhuni	
Email: afrim.maxhuni@rks-gov.net	Email: afrim.maxhuni@rks-gov.net	
Adresa e Internetit (<i>nëse aplikohet</i>):	Adresa e Internetit (<i>nëse aplikohet</i>):	

Nëse po, specifikoj identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

“ Shërbimet e mirëmbajtjes se objekteve si dhe furnizimi me material ndërtimor dhe pajisje për mirëmbajtje te objekteve te FSK-se “e ndare ne dy pjesë- Lote

Pjesa e pare – Lot 1: “Shërbimet e mirëmbajtjes se objekteve dhe infrastrukturës përcjellëse ne kazermat e FSK-se”

Pjesa e dyte – Lot 2: “Furnizim me material ndërtimor dhe pajisje për mirëmbajtje te objekteve te infrastrukturës përcjellëse te FSK-se”

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Punë	<input checked="" type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input checked="" type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve _____ _____	Vendi kryesor i dorëzimit Depot qendrore ne Kazermën “Adem Jashari” Prishtinë .	Vendi kryesor i realizimit Te gjitha lokacionet e FSK-se ne ter Kosovën: (Prizren; Istog; Pomozetin; Mitrovicë; Prishtinë; Ferizaj dhe Gjilan)

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë **Po**

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj : 24

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës për pjesën e pare- Lot - 1:

AK i MFSK-se dhe FSK-se ka për qëllim qe te lidhet një kontratë kornizë 24 muajsh ,për pjesën e pare – lot 1: “**Shërbimet e mirëmbajtjes se objekteve dhe infrastrukturës përcjellëse ne kazermat e FSK-se**” me një OE qe do te ketë kapacitet te kryej shërbime sipas kërkesës dhe nevojave me qëllim te mirëmbajtjes se objekteve te infrastrukturës se kazermave te FSK-se ne nivel te lart dhe operacional, qe përfshin shërbime te ndryshme, punë te ndryshme , montimi

dhe funksionalizimi i tyre ,demolomë dhe demontime te ndryshme.
Ne këtë pjesë – lot 1 gjithashtu janë te përfshira edhe furnizimet e nevojshme qe nevojiten gjate kryerjes se shërbimeve- punëve sipas përshkrimeve teknike te dhëna sipas situacioneve ne DT

Te gjitha punët, shërbimet dhe furnizimet duhet te jene te kualitetit te larte dhe ne përputhshmëri te plot me normat dhe standardet evropiane ne fuqi ISO- standardet te specifikave te fushave përkatëse (Pune,shërbime,materiale dhe pajisje).

Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës për pjesën e dyte – Lot 2.

AK i MFSK-se dhe FSK-se ka për qellim qe te lidhet një kontratë kornizë 24 muajsh ,për pjesën e dyte – lot 2: **“Furnizim me material ndërtimor dhe pajisje për mirëmbajtje te objekteve te infrastrukturës përcjellëse te FSK-se”**, me një OE qe do te ketë kapacitet te kryej furnizime me materiale ndërtimore sipas kërkesës dhe nevojave me qellim te mirëmbajtjes se objekteve te infrastrukturës se kazermave te FSK-se, si dhe furnizimin me materiale te tjera dhe pajisjeve te ndryshme sipas sipas nevojave dhe përshkrimeve teknike te dhëna ne DT .

Te furnizimet duhet te jene te kualitetit te larte dhe ne përputhshmëri te plot me normat dhe standardet evropiane ne fuqi ISO- standardet te specifikave te fushave përkatëse (materiale dhe pajisje).

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

Lot 1 : 93&50

Lot 2 : 28

II.1.7) Variantet pranohen

Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

Të gjitha pjesët

II.1.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve (nëse aplikohet):

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:
Ne te gjitha pjesët pa kufizime.

II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

<i>Nr.i situacioneve</i>	<i>Përshkrimi i shkurtër i punëve për pjesën e pare – Lot 1</i>
1.	Demolimet,qmontimet,thyrjet,largimet
2.	Punët tokësore përfshi edhe furnizimet sipas përshkrimit ne DT

3.	Punët e betonit përfshi edhe furnizimet sipas përshkrimit ne DT
4.	Punët e armaturës përfshi edhe furnizimet sipas përshkrimit ne DT
5.	Pune te ndryshme përfshi edhe furnizimet sipas përshkrimit teknik ne DT
6.	Punët e elektrikes përfshi edhe furnizimet sipas përshkrimit ne DT
7.	Ujsjelles, sanitari, kanalizim furnizim dhe montim
8.	Ngrohje qendrore furnizim dhe instalim
9.	Punët metalike, furnizim dhe montim
10.	Punimet e ventilimit dhe furnizimet sipas përshkrimit ne DT
Nr.i situacioneve	Përshkrimi i shkurtër i furnizimeve për pjesën e dytë – Lot 2
1.	Materiale (pajisje)elektrike
2.	Materialet nga druri
3.	Zdrukthëtari
4.	Materiale hidraulike
5.	Materiale ndërtimi
6.	Pajisje te ndryshme
7.	Materiale për ngjyrosje
8.	Materiale te ndryshme
II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: <i>Vlera e përfaqësuar vjetore e kontratës për pjesën e parë – Lot 1 : 400,000.00€, dhe për pjesën e dytë Lot 2 : 100,000.00€</i>	

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) Sasia e përfaqësuar vjetore e cila është planifikuar për të dy pjesët – Lotët është e dhënë ne DT dhe kjo sasi mund të ndryshoj +/- 30 % nga vlera e kontratës baze, komfor udhëzuesit administrativ Nr.2/2015 për kontratat publike kornizë neni 5 (5.1 dhe 5.2) .

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj 24 (nga nënshkrimi i kontratës)

Apo:

Kontrata për pjesën e pare – Lot 1 do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të sajë dhe do të zgjasë 24 muaj apo vite 2 kurse për fillimin e shërbimeve të mirëmbajtjes - punëve do të fillojë të realizojë në afat prej max 3 orëve nga momenti i thirrjes (intervenimet duhet të jenë 24/7 duke llogaritur edhe ditët festive dhe në të gjitha lokacionet sipas kërkesës dhe nevojave të AK dhe në përputhje me specifikacionin teknik të dhënë në DT.

Kontrata për pjesën e dytë – Lot 2 do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të sajë dhe do të zgjasë 24 muaj apo vite 2 kurse afati i liferimit të mallrave do të zgjasë max 30 dite nga momenti i nxjerrjes së urdhër blerjes sipas kërkesës dhe nevojave të AK dhe në përputhje me specifikacionin teknik të dhënë në DT.

ENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës për secilën pjesë të veçanta me kohëzgjatje 25 muaj.

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

Themelimi i entitetit ligjor në përputhje me dispozitat e parashikuara në dokumentet e tenderit.

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

Për pjesën e parë – Lot 1 : Te gjitha punët, shërbimet dhe furnizimet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe në përputhshmëri të plot me normat dhe standardet evropiane në fuqi ISO- standardet të specifikave të fushave përkatëse (Punë,shërbime,materiale dhe pajisje).

Për pjesën e dytë – Lot 2 :Te gjitha furnizimet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe në përputhshmëri të plot me normat dhe standardet evropiane në fuqi ISO- standardet të specifikave të fushave përkatëse (materiale dhe pajisje).

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Deklaratë nën betim** - Operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.
- Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore** e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
- Vërtetimin nga Gjykata Themelore** - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent

gjqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për **Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD)** të dosjes se tenderit te [Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik](#), (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- a. **Deklaratë nën betim** (Originali).
- b. **Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore** - Original
- c. **Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike** - Origjinal .

Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fitues**, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me procedura te tjera konform LPP-se.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit , ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovë LPP Nr 04/L-042 është i detyruar të paraqesë certifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme-para nënshkrimit të kontratës.
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Dëshmi ose një kopje e certifikatës së biznesit- Kopje
2. Një kopje të certifikatës se TVSH- Kopje
3. Një kopje të certifikatës se numrit fiskal- Kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se qarkullimet vjetore gjate tri viteve te fundit (2013,2014 dhe 2015) ka qene ne vlere, se bashku për tre vitet , por jo me pak se.

1. Për pjesën e pare – Lot 1 , 800,000.00€
2. Për pjesën e dyte – Lot 2 , 200,000.00€

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 pjesë (lote), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për Lotët për te cilat ai konkurren duhet të përmbushet nga OE.

Shembull: nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 800,000.00 dhe për Lot 2 është 200,000.00, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE është 1,000,000.00 euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar – origjinal

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjte gjate 3 (tri) vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) jo me pak se;

Për lot 1: 600,000.00 Euro

Për lot 2: 150,000.00 Euro

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 pjesë (lote), shuma totale e kontratave te natyrës se njëjte qe kërkohet për Lotët për te cilat ai konkurren duhet të përmbushet nga OE.

Shembull: nëse shuma totale e kontratave te natyrës se njëjte te kërkuar për Lot 1 është 600,000.00 dhe për Lot 2 është 150,000.00, atëherë kërkesa minimale për shumen totale te kontratave te natyrës se njëjte e cila duhet te përmbushet nga OE është 750,000.00 euro.

Kërkesa 2 .OE duhet te ofroj dëshmi listën e punëtorëve të përhershëm të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim: Emrin, mbiemrin , moshën e punëtorit, profesioni, eksperiencën (vite) dhe pozicionin në kompani për min 20 punëtor (te profileve të ndryshme si mjeshër ; elektrikist; murator; agjuntator; mirëmbajtës të nxemjeve qendrore; instalues ujësjellësi e tj,) **vetëm për pjesën e parë – Lot 1**

Kërkesa 3.OE duhet të prezantoj stafin Professional dhe menaxherial për pjesën e parë – Lot 1:

- Një menaxher të projektit, për pjesën e parë të cilët duhet të jenë Inxhinier të Diplomuar i ndertimtaris ose ing i arkitektures, me përvojë min 5 vjeçare, **vetëm për pjesën e parë**
- Stafi profesional që duhet të prezantohet për min :
 1. nje ing te ndertimtaris ose hidro ndertimtaris;
 2. Nje ing te arkitektures;
 3. Nje ing te makineris;
 4. Nje ing te elektroteknikes;
 5. Nje teknik te ndertimtaris;
 6. Nje teknik te elektros; dhe
 7. Nje teknik te makineris

Kërkesa 4.OE duhet te ofroj dëshmi raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit pjesë të këtij tenderi për pjesën e parë. (numri dhe përshkrimi i saktë/lloji i automjetit si dhe pajisjet e tjera) që disponon kompania;/ librezë e regjistrimit me fotografi , fatura e blerjes ose kontrata e marrjes me qira të pajisjeve për projektin në fjalë, **vetëm për pjesën e parë**, për min :

- Kamion 1 (nje) cop
- Autovinç 1(nje) cop
- Ngarkues ose bager 1 (nje) cop
- Mjete të tjera të punës në bazë të specifikave të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1. Listën e kontratave të natyrës së njëjtë të nënshkruar dhe realizuara në 3 vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) për të dy pjesët – lotët. duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vëlosur nga Operatori Ekonomik.

Dëshmitë:

- Referencat sipas listës së kontratave të prezantuara për furnizimet e ngjashme të cilat duhet të tregojnë vlerën, datën, natyrën e projekteve /apo aktivitetëve të

furnizimit dhe duhet të saktësojnë ne referencë nëse janë kryer furnizimet sipas kërkesës së AK, gjatë tre viteve të fundit në vlerë prej min 600,000.00 Euro për pjesën e parë – lot 1 , dhe për pjesën e dytë në vlerë prej min 150,000.00 Euro .
Vërejtje:

- Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca ose pranimit teknik për kryerjen shërbimeve- punëve si dhe furnizimeve.

Evidenca 2. Pasqyrat tabelore e punëtorëve të përhershëm të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim: Emrin, mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencë (vite) dhe pozicioni në kompani: **duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik vetëm për pjesën e parë – Lot 1.**

Evidenca 3: dëshmi për stafin profesional dhe menaxheria për pjesën e parë – Lot 1 :

- Vendim me shkrim mbi caktimin e një menaxheri të projektit **i vulosur dhe nënshkruar nga OE në origjinal**
- Dëshmitë për menaxher të projektit :Kopja e diplomave të noterizuar nga origjinali-(Kopja e diplomës duhet të dorëzohet e noterizuar në origjinal nga noteri) , CV-it , kopja e kontratave të punës ose para kontratave në origjinal me emër të projektit në fjale.
- Listën e stafit profesional duke ofruar dëshmi për secilin inxhinjer dhe teknik : Kopja e diplomave apo certifikatës e noterizuar nga origjinali, CV , kopja e kontratave të punës ose para kontratave në origjinal me emër të projektit në fjale.

Evidenca 4 : Dëshmi raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit pjesë të këtij tenderi për pjesën e parë. (numri dhe përshkrimi i saktë/lloji i automjetit si dhe pajisjet e tjera) që disponon kompania;/ librezat e regjistrimit me fotografi , fatura e blerjes ose kontrata e marrjes me qira të pajisjeve për projektin në fjale, **vetëm për pjesën e parë,**

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

[klike njërin dhe fshij te tjerat]

IV.1.1) Lloji i procedurës

E hapur

IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociatë) Jo

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociatë)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
Autoritetet kontraktuese do të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
IV.1.4) Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është :		[shëno numrin]

IV.2) KRITERET E DHËNIES

[Shëno në kutinë e duhur dhe fshije tjetrën]

Tenderi i përgjegjshëm Çmimi më i ulët

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Kushtet për marrjen e <i>dosjes së tenderit</i>		
Afati i fundit për pranimin e kërkesave për <i>dosjen e tenderit</i> : data 15/04/2016 në çdo ditë të punës në Kazerma “Adem JASHAR” Prishtinë apo në email adresën afrim.maxhuni@rks-gov.net		
Dokumentet me pages	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Afati i fundit për pranim të <i>tenderëve</i>		
19/04/2016 <i>koha</i> 13.00 <i>vendi</i> Objekti i MFSK-se ,Kazerma “Adem JASHARI” Prishtine,		
IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e <i>[tenderëve][aplikacioneve]</i> është shkurtuar:		
<input checked="" type="checkbox"/> jo		
IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:	Po	<input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po</i> , vlera e sigurisë së tenderit: Për pjesën e parë – Lot 1 : 12,000.00€ Për pjesën e dytë – Lot 2 : 3000.00€		
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj 4		
IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: ditë 90 apo muaj 3		
IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:		
19/04/2016 <i>koha</i> 13.30 <i>vendi</i> Objekti i MFSK-se ,Kazerma “Adem JASHARI” Prishtine,		

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: [si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj]